



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 6 parag.1.2 dhe 14 paragrafi 3 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, dhe neneve 14, 15 parag. 2.4, dhe nenin 17 parag. 1 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2019, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 08 maj 2019, miratoi,

VENDIM

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË FSHATIN DUMNICË E POSHTME

Neni 1

Miratohet vendimi paraparak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik, pronën e paluajtshme të Komunës;

- Njësitë kadastrale parcela P-71712026-00074-1 me sipërfaqe të tërësishme prej 20985 m² me kulturë kullosë klasa e 3 vendi i quajtur, “Repaja te varrezat” Zona Kadastrale Dumnicë i Poshtme, pronë e Komunës e evidentuar në, Certifikatën 08-942-03/34014 të datës 23.04.2019.

- Sipërfaqja që do jepet në shfrytëzim me qira është 2000m². Pjesë nga sipërfaqja totale e P-74-1, S = 20985 m².

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, është shfrytëzimi për qëllime bujqësore, krijim i mundësive për vende të reja të punës dhe rritje e të hyrave vetanake.

Neni 3

Afati kohor për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 sipas këtij propozim vendimi është afatgjatë përkatësisht në periudhë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.

Neni 4

Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi, pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore.

Neni 6

Zbatimin e Vendimit e bëjnë Komisioni vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-462/01-0037927/19
Podujevë, 08 maj 2019



A.2 LLOJII I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri i Broy Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i Klasisë Kualitet Klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area
1	Bujqësori/Poljoprivredno/Agriculture	Kullam/Tesik/Canal	Kullamishite 1 Klase/3 Tesike/3 Klase 3rd Class Canal	20985

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Postanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drajvina / Single possessor	" PRONË E KOMUNËS "	KCID914118364	PODUEVE / PODUEVO /PODUEVE /			1/1	Rovënshtë i paraqitëve 4 2006 DT: 15.11.2005	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : **PODUJEVË**
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: **Dumnice e poshtme**

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71712026-00074-0		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2208

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 23.04.2019

Koha/ Vreme/ Time: 10:14:20

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note: Parcela 74-1 sip 20985 m2

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejteri/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

